



Nr i prot.: 201
Me datë: 25/10/2024
Rahovec

Në bazë të nenit 80 dhe 81 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 neni 8, neni 5 i Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, dhe në bazë të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Kujdesi Parësor Shëndetësor nr.04/2020 neni 21 pika 3 dhe në bazë të Statutit të QKMF-së, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, shpall këtë:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës:	Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Fahredin Hoti” Rahovec, një (1) pozitë;
Institucioni:	Komuna e Rahovecit;
Drejtoria:	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
Lloji i pozitës:	Nëpunës i Shërbimit Publik;
Numri i Pozitave:	Një (1);
Titulli i mbikëqyrësit:	Drejtori i DShPS-së;
Kategoria funksionale:	Nivel Drejtues;
Grada/Koeficienti:	Klasa H-4, Koeficienti 12.5;
Kohëzgjatja e Kontratës:	Me kohë të caktuar (mandat 4 vjeçar);
Orët e punës:	40.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punën e QKMF-së, si dhe për punën profesionale të QKMF-së, e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe akteve tjera ligjore.
2. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për përkujdesje efektive në shëndetësinë parësore për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit dhe përgjigjet për detyrat në vijim:
 - a) Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor, drejtori i QKMF-së i propozon për miratim Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale planin e punës dhe buxhetin e QKMF-së për vitin vijues;
 - b) Drejtori është përgjegjës për zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
 - c) Nen mbikëqyrjen dhe autorizimin e drejtorit të QKMF-së, zbaton buxhetin e QKMF-së;
 - d) Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
 - e) Vendos marrëdhënie të mira me donatorët dhe OJQ-të, si dhe me partnerët për zbatimin e tyre;
 - f) Mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së;
 - g) Vendos mekanizmat e sigurimit të cilësisë në objektet e KPSH-së së komunës;
 - h) Jep kontribut për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së sipas standardeve të pranuar dhe siguron mbledhjen e informatave;
 - i) Avancoon punën ekipore.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin universitar dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:

- Specialist i mjekësisë familjare.
- Kandidati duhet të ketë së paku 3 vjet përvojë pune në shëndetësi, përparësi duhet t’u jepet kandidatëve me përvojë në procesin e implementimit të mjekësisë familjare, trajnimeve në menaxhment shëndetësor dhe shëndetësi publike.

Dokumentet e nevojshme:

- Dëshminë për shkollimin (e vërtetuar);
- Licenca e punës (e vërtetuar);
- Dokumentin e identifikimit;
- Certifikatën që nuk është nën hetime (nga Gjykata);
- Dëshmi mbi përvojën e punë;
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore (për arsye të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve, kjo kërkohet në fund të procedurës së rekrutimit vetëm nga kandidati më i suksesshëm);
- Certifikatën që dëshmon njohuri nga kompjuteri dhe njohuri të tjera (e dëshirueshme);
- Kualifikime të tjera (trajnime).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

- Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda **30 ditëve**, nga data **25.10.2024** deri më **23.11.2024 (16:00 h)**.
- Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në zyrën e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në komunën e Rahovecit.
- Formulari i aplikimit merret /shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>.
- Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohen, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Rahovec, më 25.10.2024



Drejtoreshë e DShPS-së

Saranda Sallteku